

Newsletter Bota e SIGAL UNIQA

25 vite histori sukcesi

Kompania s sigurimit për një jetë më të mirë të gjithë bashkë

Nr. 1 i
sigurimeve
në Shqipëri,
Kosovë dhe
Maqedoni e
Veriut



Ja ku takohemi sërish me "Bota e SIGAL UNIQA" me zhvillimet kryesore të Grupit për vitin 2023. Ky vit ishte i mbushur me aktivitete dhe zhvillime motivuese për të ardhmen në të trija shtete të grupit: Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë.
Por pa harruar edhe kompaninë mëmë, "UNIQA Insurance Group", me seli në Vjenë.
Lexim të këndshëm



PËRMBAJTJA

INr.1 i sigPonari: Shkrirja me “UNIQA”-n, ngjarja më e madhe për SIGAL	4
Ponari: Gjithmonë një hap përpara të tjerëve	7
Brandstetter: Po investojmë rreth 50 milionë euro çdo vit	9
2023, një tjetër faqe suksesi/ SIGAL UNIQA e mbyll vitin në krye të tregut të sigurimeve	12
Primet u rritën me 10%, fitimet para taksave deri në 426 milionë euro	14
SIGAL UNIQA certifikohet me “ISO 27001:2022.....	16
“The Best Of Kosovo 2023”/ SIGAL UNIQA shpallet sërish “Tatimpaguesi i Vitit”	17
Planet dhe sfidat për 2024-ën	18
Ponari: Do të duhej të kishim 20-30% të të punësuarve kontribuues	19
UNIQA, anëtare e Eurapco Alliance	20
Sponsorizimi i Kombëtares / Ponari: Vjen në kuadër të përgjegjësisë sociale të kompanisë, detyrim moral ndaj 1.2 milionë klientëve në 3 shtete	23
UNIQA, kompania e parë austriake me synim në zvogëlimin e emetimeve	26
Orkestra "SIGAL UNIQA" ngroh shpirtrat e të pranishmëve me tingujt mahnitës të Vivaldit	28
SIGAL Audiobooks.al iu ribashkua Panairit të 26-të të Librit.....	29
‘UNIQA’ vijon traditën, dorëzon çekun për “Caritas Austria”	30

2023, VIT SUKSESESH DHE ARRITJESH KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE

Kanë kaluar 25 vite nga themelimi i kompanisë por një gjë ka mbetur e pandryshuar: besimi i qytetarëve dhe bizneseve për ti besuar gjithçka me vlerë SIGAL UNIQA Group Austria-s.

Grupi më i madh i sigurimeve në Shqipëri dhe rajon e mbylli vitin 2023 sërish në krye të tregut, si për primet e grumbulluara ashtu edhe për dëmet e paguara.

Një vit i mbushur me arritje kombëtare dhe ndërkombëtare, ku një meritë të veçantë ka stafi i kompanisë në tre shtete, Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut por edhe stafi drejtues.

Duke uruar që edhe viti 2024 të jetë edhe më i suksesshëm, SIGAL UNIQA Group Austria falenderon mbi 1.2 milionë klientët e saj për besimin e palëkundur në çerek shekulli.

SIGAL UNIQA Group Austria, jetojmë më mirë së bashku!

Të jesh i sigurt nuk është kurrë mjaftueshëm...

Siguroni biznesin tuaj
nga fatkeqësitë natyrore
dhe mbroni investimet
tuaja.

Merr një
ofertë

sigal.com.al
+355 4 2233 308





rritemi më mirë së bashku

Ngjarjet kryesore

25 vite histori sukcesi

SIGAL 
UNIQA GROUP AUSTRIA

Ponari: Shkrirja me “UNIQA”-n,
ngjarja më e madhe për SIGAL

25 vite histori
sukcesi



Kompania më e madhe e sigurimeve, SIGAL UNIQA Group Austria, festoi mbrëmjen e djeshme 25-vjetorin e themelimit.

Në një koncert festiv në Teatrin Kombëtar të Operas dhe Baletit, i ideuar në atë formë që të përfaqësonte të trija shtetet ku është prezent Grupi SIGAL UNIQA, Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut, qindra të ftuarit shijuan interpretimet magjike të tenorit me famë botërore Ramë Lahaj, sopranos Ulpiana Aliaj, këngëtares nga Maqedonia e Veriut Karolina Goçeva dhe Ansambli Kombëtar të Këngëve dhe Valleve. Koncerti u moderua nga dyshja Ardit Gjebrea-Fjoralba Ponari, ndërsa nuk mungoi edhe shfaqja e një dokumentari ku u shfaq i gjithë rrugëtimi 25-vjeçar i SIGAL UNIQA-s.

Gjatë fjalës së tij përshëndetes, z.Avni Ponari, themelues dhe CEO i SIGAL UNIQA, bëri një rezymë të të gjithë ecurisë gjatë këtyre 25 viteve, idetë e para të themelimit, vështirësitë që kishte ky udhëtim në hapat e parë dhe arritjet gjatë këtij çerekshkulli. Sipas tij, ngjarja më e madhe në 25 vitet e SIGAL është padyshim shkrirja me

kompaninë e njohur austriake “UNIQA Insurance Group”.

“Ngjarja më e madhe në jetën 25 vjeçare të Sigalit, padyshim ka qenë shkrirja me kompaninë e njohur austriake “UNIQA Insurance Group”. Gjigandi i sigurimeve evropiane ofroi të ishte partneri ynë duke i dhënë kompanisë tonë një dimension ndërkombëtar.

Ne sot e themi me plot gojë se SIGAL është në Europë, jo vetëm për shërbimin por edhe për standartet evropiane që aplikon në çdo aspekt.

Tashmë pozita lider është konsoliduar. Klientët tanë kanë një siguri të pakrahasueshme për mbështetjen dhe garancitë që ofron SIGAL UNIQA.

Sigal u bë e para kompani shqiptare me partner ndërkombëtar duke garantuar tregun përmes investitorëve strategjikë, jo vetëm në Shqipëri por edhe në Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut”, tha gjatë fjalës së tij Ponari.

I ftuar në event ishte edhe CEO i “UNIQA Insurance Group”, z.Andreas Brandstetter, i





cili foli me superlativa për punën dhe arritjet e SIGAL UNIQA gjatë 25 viteve, në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut.

“Jam shumë i lumtur dhe krenar si president i Grupit “UNIQA Insurance Group” për kontributin e SIGAL në rritjen e mirëqënies së qytetarëve pasi ata menduan të kujdesen për të gjitha të mirat e tyre.

Kjo është diçka që ju dhe skuadra juaj sollët me shumë qëndrueshmëri në treg.

Nëse kthehemi pas para 25 vjetësh ajo që ndodhi ishte e mrekullueshme dhe padyshim e pabesueshme. Shkëlqimi me elasticitet me guxim për të ndërtuar një kompani sigurimesh private kërkon shumë. Dhe ne ja kemi arritur”, tha ndër të tjera Brandstetter.

Mbrëmja vijoi me përshtypjet e Reshat Arbanës, aktorit të mirënjohur që për shumë vite ka qenë edhe imazh i kompanisë, të presidentit të klubit më të famshëm të basketbollit në Kosovë SIGAL Prishtina, Blerand Stavileci dhe të një prej shumë klientëve të dëmshpërbyler nga SIGAL UNIQA.

Eventi u mbyll në mënyrën më të bukur të mundshme, teksa në skenë zbrit për të performuar Ansambli i Këngëve dhe Valleve, vallet dhe këngët e të cilit ngritën në peshë publikun.

E themeluar në Shkurt 1999 dhe pjesë e

“UNIQA Insurance Group” prej vitit 2007, SIGAL UNIQA operon suksesshëm në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut përmes 8 kompanive të saj: 3 Sigurimi Jo-Jete, 3 Sigurimi Jete, 1 kompani risigurimi dhe 1 Fond Pensioni duke kryesuar tregun në këto shtete e duke qenë edhe mes Top 50 kompanive më të mëdha në Europën Juglindore.

Falë strategjisë së tij “par excellence”, modelit të biznesit, menaxhimit financiar dhe stafit profesional, kompania është rritur vit pas viti duke arritur sot një pozicion dominues në tregun shqiptar dhe rajonal të sigurimeve.

Sot, “SIGAL UNIQA Group AUSTRIA” është e vetmja kompani që ofron të gjitha klasat e sigurimeve, duke numëruar mbi 2400 punonjës e agjentë në mbi 1200 zyra në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut, ku operohet me standarte tërësisht evropiane.

Mbi 500 milionë euro dëme të paguara në 25 vite, janë dëshmia më e madhe e fuqisë, përgjegjshmërisë dhe korrektësisë të “SIGAL UNIQA Group Austria”.

Ndaj dhe sot, nën moton “Jetojmë më mirë së bashku”, mbi rreth 1.2 milionë klientë vazhdojnë ti besojnë kësaj kompanie jetën, shëndetin, pronën, automjetin dhe pensionin privat.

SIGAL UNIQA, 25 Vjet lider në treg Ponari: Gjithmonë një hap përpara të tjerëve



Kompania më e madhe dhe më e besuar e sigurimeve, SIGAL UNIQA Group Austria, kremton 25-vjetorin e themelimit të saj, ngjarje për të cilën u organizua një takim me stafet e kompanisë në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut ku u diskutua mbi arritjet gjatë këtij çerekshekulli dhe objektivat për të ardhmen.

Takimi u hap nga themeluesi dhe CEO i "SIGAL UNIQA", z.Avni Ponari, i cili rënditi sukseset dhe arritjet e kompanisë gjatë këtyre 25 viteve.

Sipas tij, aagjë nuk ka qenë e lehtë në fillim, ndërsa falë punës së kryer, shërbimit profesional ndaj klientit, produkteve më novatore në treg dhe pagimi në kohë i dëmeve ka bërë që sot Grupi "SIGAL UNIQA" të jetë lidere e sigurimeve në Shqipëri, Kosovë e Maqedoninë e Veriut dhe mes 50 më të mëdhave në Evropën Juglindore.

"Sot është një ditë e veçantë. Një ditë që na bën të ndjejmë pak emocione dhe ta shohim të ardhmen ndryshe. Sepse ne ishim ata që filluam me pak kapital dhe sot kemi arritur në këto shifra që janë shumë të rëndësishme. Kjo është puna juaj, puna e gjithë stafit, është puna e jona gjatë gjithë këtyre viteve.

Nga ana tjetër ne jemi shtuar, jemipërmirësuar dhe kemi arritur në këto rezultate, të cilat mendoj janë mjaft të mira", tha ndër të tjera në fjalën e tij themeluesi dhe CEO i Grupi "SIGAL UNIQA", z.Avni Ponari.

"Ne jemi më mirë se të tjerët. Jemi të parët! Edhe Kosova, edhe Maqedonia e Veriut dhe ne të gjithë si grup. Dhe llogaritemi mes 48 kompanive më të mëdhaja të Europës Juglindore. Çka na bën krenarë për punën që kemi bërë.

Gjithmonë kemi pasur si synim të kemi inovacione. Kemi qenë kërkues ndaj vetes. Kemi kërkuar që gjithçka ta bëjmë si duhet. Por idetë tona gjithmonë kanë qenë në konflikt me ata që zhvillojnë IT-në. Pavarësisht se ata janë shumë më lart por në zbatimin e ideve tona, programeve tona, ata nuk kanë arritur ti përgjigjen nivelit të kompanisë sonë. Dhe kjo kërkon më shumë punë për të ardhmen sepse sot industria e sigurimeve, ajo bankare dhe e financave në përgjithësi janë 100% të automatizuara. Duke i shërbyer më mirë klientit se në fund të fundit ky është qëllimi.

Në gjithë punën tonë jemi nisur nga disa

parime dhe norma mbi të cilat kemi bërë përndërtimin e strukturës së SIGAL-it, mbi bazën e departamenteve, në mënyrë që të jemi ndryshe nga ato që kanë kompanitë e tjera. Dhe kjo ka qenë e veçanta jonë.

Pse ne ecim më mirë se të tjerët?

Kemi një brand të besuar, kemi një emër të besuar. Edhe ata me të cilët bashkëpunojmë janë ndër emrat më të rëndësishëm në Europë. Produktet më të mira. Kemi qenë lider. Ne kemi nxjerrë një produkt, tregjet kanë ardhur pas nesh. Kemi qenë gjithmonë përpara, në të gjitha produktet”, vijoi më tej Ponari.

Pas z.Ponari, fjalën e morën drejtuesit e departamenteve në SIGAL UNIQA Group Austria dhe drejtuesit e kompanisë në Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut, të cilët bënë një bilanc të punës gjatë viteve të kaluara dhe planet për vitet në vijim.

Më pas, z. Ponari ndau “Statujat e Mirënjohjes” për punonjësit dhe agjentët me më shumë vite kontribut në “SIGAL UNIA”.

Takimi u mbyll me një drekë festive, nën tingujt e gëzueshëm të Orkestrës së Harqeve “SIGAL UNIQA”.

“SIGAL UNIQA Group Austria”, një prej grupeve më të mëdha të sigurimeve në rajon.

E themeluar më 22 Shkurt 1999 dhe pjesë e “UNIQA Insurance Group” prej vitit 2007, ajo operon suksesshëm në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut përmes 8 kompanive të saj: 3 Sigurimi Jo-Jete, 3 Sigurimi Jete, 1 kompani risigurimi dhe 1 Fond Pensioni.

Falë strategjisë së tij “par excellence”, modelit të biznesit, menaxhimit financiar dhe stafit gjithmonë të përzgjedhur me kujdes, SIGAL UNIQA është rritur vit pas viti duke arritur sot një pozicion dominues në treg, duke e udhëhequr atë me rreth 30% të tij.

Sot, “SIGAL UNIQA Group AUSTRIA” është e vetmja kompani që ofron të gjitha klasat e sigurimeve, duke numëruar mbi 2400 punonjës e agjentë në mbi 1200 zyra në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut, ku operohet me standarte tërësisht evropiane. Mbi 500 milionë euro dëme të paguara në 25 vite, janë dëshmia më e madhe e fuqisë, përgjegjshmërisë dhe korrektësisë të “SIGAL UNIQA Group Austria”.

Ndaj dhe sot, nën moton “Jetojmë më mirë së bashku”, mbi rreth 1.2 milionë klientë vazhdojnë të besojnë kësaj kompanie jetën, shëndetin, pronën, automjetin dhe pensionin privat.

SIGAL UNIQA Group Austria, jetojmë më mirë së bashku



“Më shumë shërbime të kujdesit shëndetësor nga një burim i vetëm”,



Brandstetter: Po investojmë rreth 50 milionë euro çdo vit

Në një intervistë për median austriake “Trend” CEO i “UNIQA Insurance Group”, Andreas Brandstetter ka folur ndër të tjera mbi investimet që grupi që ai kryeson po bën kryesisht në shëndetësi.

Sipas Brandstetter, në sajë të investimeve të rëndësishme, rreth 50 milionë euro në vit, UNIQA u mundëson 4 milionë klientëve të saj në Austri dhe 16 milionë në Europë, mundësinë e marrjes së shërbimeve shëndetësore nga një burim i vetëm.

“Po zhvillojmë shërbime për njerëz të shëndetshëm, pra për parandalim. Dy shembuj të kësaj janë ekzaminimet parandaluese gjithnjë e më të rëndësishme ose testet në shtëpi që sapo përmendëm. Dhe nga ana tjetër investojmë shumë edhe në “riparime” mjekësore të shpejta dhe të klasit të parë.

Kjo është arsyeja pse po investojmë miliona euro për vitet e ardhshme me qëllim zgjerimin e një nga 5 spitaleve tona private, përkatësisht klinikën private Döbling në Vjenë.

Shifrat tregojnë se ne po investojmë shumë për klientët tanë, rreth 50 milionë euro në vit”, shprehet ndër të tjera CEO i “UNIQA”.

INTERVISTA:

Ju dëshironi të zgjeroni UNIQA-n drejt një ofruesi të kujdesit shëndetësor. Pse nuk ju mjafton më sigurimi me disa spitale private?

Andreas Brandstetter: Sepse nuk mjafton më për klientët tanë. Aktualisht punojmë për 16 milionë klientë në të gjithë Evropën, rreth 4 milionë prej të cilëve jetojnë në Austri. Nën markën tonë të re Mavie, ne ju ofrojmë më shumë shërbime shëndetësore nga një burim i vetëm.

Fokusi aktual: shëndeti mendor, testet në shtëpi për shëndetin parandalues dhe kujdes 24 orë të ditës në 7 ditë të javës.

Sa para dëshironi të investoni në zgjerimin e sektorit të kujdesit shëndetësor në vitet e ardhshme?

Andreas Brandstetter: Ne kemi dy drejtime: Nga njëra anë, zhvillojmë shërbime për njerëz të shëndetshëm, pra për parandalim. Dy shembuj të kësaj janë ekzaminimet parandaluese gjithnjë e më të rëndësishme ose testet në shtëpi që sapo përmendëm. Dhe nga ana tjetër investojmë shumë edhe në “riparime” mjekësore të shpejta dhe të klasit të parë.

Kjo është arsyeja pse po investojmë 60 milionë euro për vitet e ardhshme me qëllim zgjerimin e një nga 5 spitaleve tona private, përkatësisht klinikën private Döbling në Vjenë.

Shifrat tregojnë se ne po investojmë shumë për klientët tanë, rreth 50 milionë euro në vit.

Me Mavie Next ju keni krijuar njësinë tuaj inovative për çështjet shëndetësore. Cilat janë sfidat?

Andreas Brandstetter: Gjërat nuk mund të ecin aq shpejt, sepse zhvillimet globale në fushën e shëndetit, veçanërisht ato dixhitale, po përparojnë shumë shpejt. Kështu që nuk duhet humbur kontakti!

Ajo që kemi tashmë në portofolin tonë, ne jemi lider në Austri dhe me Mavie Work në fushën e shëndetit në punë, ne duam të vazhdojmë të rritemi. Duke investuar në Biome Diagnostics, ne kemi bërë një hap përpara. Po bashkojmë testet e gjakut të marra në shtëpi me testet e mikrobiomës së zorrëve nga Biome Diagnostics nën emrin Mavie me, sepse ne besojmë se informacioni mbi gjëndjen shëndetësore të dikujt është shumë i rëndësishëm pasi është pjesë e parandalimit.

Çfarë rëndësie duhet të ketë sektori shëndetësor për Uniqa-n në planin afatgjatë?

Andreas Brandstetter: Mënyra se si do të zhvillohet ekosistemitshëndetësor për grupin në afat të gjatë varet nga sa mirë dhe shpejt mund të zhvillojmë shërbime të klasit të parë për klientët tanë.

UNIQA Insurance Group, një ndër kompanitë më të njohura të sigurimeve në Evropë, e themeluar në vitin 1811, prej marsit 2007 është pjesë edhe e tregut rajonal të sigurimeve, në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut përmes Grupit “SIGAL UNIQA”.

“UNIQA” numëron mbi 16 milionë klientë në 17 shtete të ndryshme të Europës ndërsa është vlerësuar së fundmi nga “Standard & Poor’s” me “A”.

UNIQA Insurance Group solli për herë të parë në Shqipëri, përmes SIGAL UNIQA, Sigurimin Privat të Shëndetit ndërsa sot kjo e fundit numëron mbi 1,2 milionë klientë në tre shtete duke qenë lider e sigurimeve në rajon dhe një prej 50 më të mëdhave në Evropën Juglindore.



Më mirë të jesh i përgatitur për çdo të papritur

Mbroni 100% veten dhe familjen tuaj nga kostot financiare në rast sëmundje të papritur me Sigurimin e Shëndetit nga SIGAL UNIQA

**Apliko
Online**

sigal.com.al
+355 4 2233 308



Më e madhja në prime dhe dëme të paguara

2023, një tjetër faqe sukseesi/ SIGAL UNIQA e mbyll vitin në krye të tregut të sigurimeve



Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare (AMF) ka publikuar raportin mbi ecurinë e tregut të sigurimeve në Shqipëri, për vitin 2023.



Sigurimet e Jo-Jetës vijojnë të jenë dominuese në treg duke sjellë 92% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, ndërsa Sigurimet e Jetës mbeten në rreth 8%.

Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut, sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 39% dhe ato të sigurimit të detyrueshëm 61% të totalit të tregut.

SIGAL UNIQA Group Austria vijon të jetë kompania më e madhe dhe më e besuar e sigurimeve në Shqipëri, si për sigurimet e Jo-Jetës, ashtu edhe në ato të Jetës.

SIGURIMET E JO-JETË



Në Sigurimet e Jetës, SIGAL LIFE UNIQA Group Austria mbetet lidere në treg, me një diferencë të theksuar me 3 kompanitë e tjera që operojnë. Edhe në dëmet e paguara, SIGAL LIFE UNIQA është kompania numër 1 në treg.



SIGURIMET E JETËS



Edhe sa i përket Sigurimit të Detyrueshëm apo Vullnetar, SIGAL UNIQA ruan lidershipin në treg, duke u konfirmuar edhe një herë si kompania e sigurimit më e besuar në vendin tonë.

SIGURIMET E DETYRUESHME DHE VULLNETARE



Pesha specifike (në %) e sigurimeve vullnetare kundrejt totalit
46.15%

pozicioni në treg
Nr. 1 në treg operojnë 8 kompani



SIGAL UNIQA Kosovë e mbyll vitin 2023 si lidere e tregut të sigurimeve

Për vitin 2023, sipas të dhënave të sapopublikuara nga Banka Qëndrore e Kosovës, SIGAL UNIQA Group Austria mbetet kompania më e madhe.

Sipas BQK, gjatë gjithë 2023 SIGAL UNIQA ka ruajtur pozitën e liderit në treg duke shënuar një volum primesh prej 19,046,899 eurosh.

Nga 10 kompanitë që operojnë në tregun e sigurimeve të jo-jetës, SIGAL UNIQA Kosovë zë 14% të tij.

UNIQA Maqedoni e Veriut mbetet zgjedhja e parë e të siguruarve!

Gjatë vitit 2023, pronarët e automjeteve në Maqedoninë e Veriut shpenzuan 87 milionë euro për sigurimin e detyrueshëm të automjeteve.

Sipas Agjencisë së Mbikqyrjes së Sigurimeve, nga kjo shumë 21 milionë euro kanë shkuar vetëm për produktin “Kartoni Jeshil”.

Numri total i sigurimit të detyrueshëm të automjeteve është rritur me 5% krahasuar me një vit më parë, raporton AMS.


Gjatë vitit 2023, 11 kompanitë e sigurimeve kanë lëshuar 260,815 polica “Karton Jeshil”, numri i të cilave është rritur me 20 mijë krahasuar me vitin 2022.

Primet e grumbulluar për këtë sigurim gjatë vitit 2023 arriti në 1,3 miliardë denarë ose 21,16 milionë euro)

Sa i përket sigurimit të detyrueshëm motoric, gjatë vitit të kaluar janë blerë gjithsej 958.528 polica ose 5,33 miliardë denarë (86,75 milionë euro).

Sa i përket kompanive të sigurimit, “UNIQA” mban vendin e parë me 14,6%, ndërsa vijojnë “Makedonija Osiguruvanje” me 4,8%, “Kroacija Osiguruvanje - Jo-Jetë” me 9,9%, “Triglav Osiguruvanje” me 8,8% dhe “Sava Osiguruvanje” me 9%, “Viener VIG” zë 13,4%, “Eurolink” 8,4%, “Grave” 8,8%, “Halk Osiguruvanje” 6,4% dhe “Osiguritelna Polica” 9,5%.

Janar - Dhjetor 2023



jetojmë më mirë së bashku

Rajonal dhe Ndërkombërt
Partneri juaj në sigurime

2023, vit i suksesshëm për “UNIQA”-n: Primet u rritën me 10%, fitimet para taksave deri në 426 milionë euro



Raporti i kombinuar është përmirësuar nga 91.7% në 89.4%

Rritje e propozimit të dividendit prej 0.57 euro për aksion

Gjatë prezantimit të bilancit paraprak për vitin 2023, “UNIQA Insurance Group AG” njofton rritje të fortë të primeve dhe fitimeve.

Sipas kompanisë me seli në Vjenë, primet e shkruara u rritën me 9.7% duke arritur në 7,185.6 milionë euro, dhe fitimet para taksave ishin 426.4 milionë euro mbi pritjet.

“Vitin e kaluar 2023, kemi bërë pagesa të larta të dëmeve të lidhura me katastrofat natyrore, kryesisht për stuhitë e ndodhura në korrik dhe gusht.

Megjithatë, viti 2023 ishte një tjetër vit financiar i suksesshëm: ne ishim përsëri në gjendje të rriteshim ndjeshëm si grup dhe të rrisim më tej fitimet tona. Kompanitë tona në EQL po zhvillohen në mënyrë të shkëlqyer dhe po japin një kontribut të konsiderueshëm në rritjen e përfitimit tonë”, shprehet Andreas Brandstetter, CEO i “UNIQA Insurance Group”.

UNIQA investon në ekosistemin e kujdesit shëndetësor

Sipas Brandstetter, “ekosistem i zgjeruar i shëndetit” është veçanërisht i rëndësishëm:

“Në Austri, 1.4 milionë klientë tashmë na besojnë shëndetin e tyre dhe me rreth 44% ne jemi lideri i tregut në sigurimet shëndetësore. Me investime të larta në ekosistemin shëndetësor nën markën Mavie,

ne kemi një qëllim të madh: të mbështesim 17 milionë klientët tanë në çështjen më të rëndësishme – shëndetin e tyre – në të gjitha situatat e jetës”.

“Për fat të mirë, austriakët priren të jetojnë më gjatë dhe më gjatë. Në mënyrë që ata ta shijojnë këtë në nivel personal dhe në të njëjtën kohë të mos mbingarkojnë sistemin shëndetësor, ne po përpiqemi të ofrojmë shërbime inovative në lidhje me shëndetin dhe parandalimin me Mavie”, thekson Brandstetter.

Shifrat kryesore paraprake të Grupit për vitin 2023 në detaje

“UNIQA Insurance Group AG” raporton në përputhje me standardet e reja të kontabilitetit SNRF 9 dhe SNRF 17, të cilat janë zbatuar që nga 1 janari 2023. Vlerat krahasuese për vitin 2022 jepen gjithashtu në përputhje me SNRF 9/17.

Një zhvillim pozitiv i qëndrueshëm mund të shihet në primet e shkruara nga “UNIQA Insurance Group AG”, duke përfshirë pjesën e kursimeve të sigurimit të jetës të lidhur me njësinë dhe të lidhur me indeksin, i cili u rrit me 9.7% në 7,185.6 milion euro në 2023 (2022: 6,548.7 milion euro).

Qarkullimi i sigurimeve, të ardhurat nga nënshkrimi sipas SNRF 17, të Grupit u rrit me 12.1% në 5,994.1 milionë euro në vitin 2023 (2022: 5,346.9 milionë euro).

Këtu kontribuan të gjitha linjat dhe segmentet: sigurimi i pronës dhe viktimave u rrit me 12.9% në vitin 2023, sigurimi shëndetësor me 8.3 % dhe sigurimi i jetës me 14.2 %.

Në Austri, shitjet e sigurimeve u rritën me 8,6% duke arritur në 3,519,0 milionë euro në vitin 2023 (2022: 3,240,7 milionë euro), në kompanitë ndërkombëtare me 15,3% në 2,429,9 milionë euro (2022: 2,107,7 milionë euro).

Rezultati i investimit u rrit në 588.8 milionë euro në vitin 2023 (2022: 179.8 milionë euro).

Fitimi para taksave i Grupit UNIQA u përmirësua në 426.4 milionë euro (2022: 421.7 milionë euro sipas SNRF 4*). Biznesi ndërkombëtar, në të cilin Rusia nuk përfshihet më, po jep një kontribut veçanërisht pozitiv në këtë.

Rezultati i konsoliduar (pjesa e rezultatit të periudhës që i atribuohet aksionerëve të UNIQA Insurance Group AG) u rrit me 18.3% në 302.7 milionë euro (2022: 256.0 milionë euro).

Kthimi nga kapitali (fitimet për periudhën nga operacionet e vazhdueshme në raport me kapitalin mesatar, duke përfshirë pakicat) u rrit në 14.1 përqind në vitin raportues (2022: 11.6%). Kjo llogaritje nuk merr parasysh efektin e shitjes së planifikuar të kompanisë ruse (rezultat nga operacionet e ndërprera (pas taksave).

Raporti i kapitalit rregullator sipas Solvency II, i cili konsiderohet si tregues i kapitalizimit, ishte në një nivel të lartë në UNIQA më 31 dhjetor 2023, rreth 255% (2022: 246%).

Rezultatet në fushat e biznesit

Sigurimi i pasurisë dhe viktimave

Primet e shkruara në sigurimin e pasurisë dhe viktimave u rritën me 14.4% në 4,214.3 milion euro në 2023 (2022: 3,683.0 milion euro). Faktorët vendimtarë ishin performanca e mirë e shitjeve dhe rregullimet e indeksit.

Pavarësisht barrës së lartë të humbjeve të lidhura me motin, veçanërisht për shkak të stuhive korrik dhe gusht të kaluar, dhe humbje të mëdha të konsiderueshme, raporti i kombinuar bruto (raporti i kombinuar bruto) në sigurimin e pronës dhe viktimave u rrit në 91.7% në periudhën raportuese 89.4% mund të të përmirësohet. Një rol të rëndësishëm në këtë luan zhvillimi shumë i mirë i nënshkrimit të biznesit ndërkombëtar.

Sigurimi i shëndetit dhe jetës

Në sigurimet shëndetësore, primet e shkruara u rritën me 8,8% në 1,388,1 milionë euro në periudhën raportuese (2022: 1,275,9 milionë euro). Për këtë rritje në masë të madhe është edhe zhvillimi pozitiv në biznesin e ri.

Në sigurimin e jetës, primet e shkruara, duke përfshirë pjesën e kursimeve të sigurimit të jetës të lidhur me fonde dhe me indeks, janë lehtësisht me 0.4% në 1,583.2 milion euro në 2023 (2022: 1,589.8 milion euro).

Marzhi i ri i biznesit të Grupit UNIQA (në sigurime shëndetësore dhe të jetës, si dhe në biznesin e pensioneve) ishte 5.1% në vitin 2023 me një vlerë të re biznesi prej 160 milionë euro.

Marzhi i shërbimit kontraktual u ul në 5,266.3 milionë euro më 31 dhjetor 2023 (31 dhjetor 2022: 5,411.0 milionë euro). Ky zë i bilancit, i ri që nga SNRF 17, përfaqëson fitimet e pritshme në të ardhmen nga kontratat e sigurimit.

Perspektiva e kompanisë

Për vitin financiar 2024, i fundit i programit tonë strategjik “UNIQA 3.0 – Mbjellja e së ardhmes”, ne po përqendrohemi në përmirësimin e mëtejshëm të biznesit tonë kryesor të sigurimeve në dy tregjet tona vendase, Austri dhe EQL.

Pritjet për një rritje të fortë në sigurimet e pronës dhe shëndetit bazohen në aktivitetet e synuara të shitjes, si dhe në rregullimet që lidhen me inflacionin dhe zhvillimet e indeksit.

Megjithatë, në vitin financiar 2024 ne vazhdojmë të presim shpenzime të larta për shërbimet në sigurimet e pronës dhe shëndetësore si dhe – për shkak të inflacionit – në fushën e kostos së përgjithshme. Prandaj është thelbësore të ruhet disiplina strikte e kostos dhe të bëhen vazhdimisht optimizime në menaxhimin e kostos.

Bazuar në një raport të aftësisë paguese prej të paktën 170%, ne përpiqemi t'i lejojmë aksionerët tanë të marrin pjesë në suksesin e kompanisë sonë në mënyrë progresive, pra me pagesat e dividendëve në rritje çdo vit.

Raporti i pagesës do të mbetet i pandryshuar deri në 60%.

Këto parashikime janë subjekt i ndikimeve të mundshme negative në rezultatet tona të konsoliduara, të cilat mund të lindin nga trazirat gjeopolitike dhe pasiguritë e shoqëruara për tregjet globale të kapitalit, nga një mjedis i paqëndrueshëm i normave të interesit, zhvillimi i inflacionit në përgjithësi dhe, mbi të gjitha, nga rritja pretendon pagesa si rezultat i katastrofave natyrore. Në lidhje me këtë, ne presim që përfitimi ynë i synuar të jetë në nivelin e vitit 2023.

Standardet më të larta të sigurisë së informacionit për klientët dhe partnerët

SIGAL UNIQA certifikohet me “ISO 27001:2022

Kompania më e madhe e sigurimeve në Shqipëri dhe mes 50 më të mëdhave në Evropën Juglindore, SIGAL UNIQA Group Austria, certifikohet nga “AXE Register”, një organ certifikimi i Akredituar dhe i njohur në mbarë botën, për përmbushjen e kërkesave të Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit, sipas standardit ndërkombëtar ISO 27001:2022.

Kjo certifikatë dëshmon cilësi në implementimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të sigurisë së informacionit në Grupin SIGAL UNIQA dhe vlen në fushat e veprimtarisë së kompanisë:

- Marrja në sigurim
- Marrja në risigurim

Ky certifikim nuk është vetëm një arritje teknike për kompaninë numër 1 të sigurimeve, por gjithashtu një shenjë e qartë e angazhimit të saj ndaj klientëve dhe partnerëve duke ju ofruar standardet më të larta të sigurisë së informacionit.

Me anë të këtij certifikimi SIGAL UNIQA arrin krijon një ambient besues dhe të sigurtë biznesi duke transmetuar një imazh të lartë cilësie për shërbimet që ajo ofron.

Çfarë është ISO 27001:2022?

ISO 27001:2022 është standardi më i njohur në botë për sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit dhe u ofron kompanive të çdo madhësie, në të gjithë sektorët, udhëzime për krijimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të menaxhimit të sigurisë së informacionit.

Pajtueshmëria me ISO 27001:2022 do të thotë që një biznes ka vendosur një sistem për të menaxhuar rreziqet që lidhen me sigurinë e të dhënave që zotërohen ose trajtohen nga ajo dhe se ky sistem respekton të gjitha praktikatat dhe parimet sipas Standardit Ndërkombëtar.

Pse është i rëndësishëm ISO 27001:2022?

Me krimin kibernetik në rritje, menaxhimi i këtyre kërcënimeve mund të duket e vështirë apo edhe e pamundur.



ISO 27001:2022 ndihmon organizatat të ndërgjegjësohen për rreziqet në mënyrën më proaktive dhe të identifikojnë dhe adresojnë pikat e dobëta.

Një sistem i menaxhimit të sigurisë së informacionit, i zbatuar sipas këtij standardi, është mjeti i duhur për menaxhimin e sigurisë kibernetike dhe përsosmërinë operacionale.

Avantazhet për kompanitë që certifikohen:

- Forcon ndërfunksionalitetin e sigurisë së informacionit dhe shton besimin e klientëve dhe partnerëve
- Integron informacionin dhe sigurinë e sistemeve në strategjinë e përgjithshme të menaxhimit të rrezikut të kompanisë
- Plotëson kërkesat e palëve të interesuara (aksionarë, ligjvënës, klientë, personel, komunitet) duke garantuar qëndrueshmërinë e biznesit
- Redukton ndodhinë e ngjarjeve, që përfshijnë detyrime ligjore dhe kontraktuale
- Përmirëson marrëdhëniet me Administratën Publike
- Siguron mbrojtjen e sekreteve tregtare të kompanisë.

“The Best Of Kosovo 2023” / SIGAL UNIQA shpallet sërish “Tatimpaguesi i Vitit”

“The Best Of Kosovo 2023”, një mbrëmje gala organizuar nga Oda Ekonomike e Kosovës dhe e kthyer në traditë të përvitshme tashmë, ndau çmimet për bizneset dhe sipërmarrjet më të suksesshme në vend.

“SIGAL UNIQA Group Austria”, kompania lider e sigurimeve në Kosovë u vlerësua edhe këtë edicion me çmimin “Tatimpaguesi i Vitit 2023”.

Ky vlerësim për SIGAL UNIQA Kosova vjen pak javë pasi kompania kremtoi 20-vjetorin e themelimit.

Në dy dekada të ekzistencës së saj në tregun e sigurimeve në Kosovë, kompania jo vetëm që ka fituar besimin e qytetarëve dhe bizneseve, jo vetëm që është paguesi më i madh i dëmeve por është pjesë integrale e shoqërisë me fokus të veçantë në sport, art, kultur, edukim etj.

Ndarja e tregut të sigurimeve në Kosovë

SIGAL UNIQA Group Austria Kosovë është kompania lider e sigurimeve, si për pozicionin që zë në treg ashtu edhe për dëmet e paguara tek klientët e saj.

Kompania zë 14% të tregut në sigurimet e Jo-Jetës dhe është e para edhe në pagimin e dëmeve, 17.3% të totalit të 12 kompanive të sigurimit që operojnë në Kosovë.

MISIONI I KOMPANISË

SIGAL UNIQA Group Austria – Kosova është e fokusuar dhe e angazhuar për të sjellë tek qytetarët dhe bizneset e Kosovës produktet dhe shërbimet në kohë reale, në mënyrën më të lehtë të mundshme, kjo falë edhe aplikacioneve online që mundësojnë blerjen e siguracionit që nevojitet edhe përmes celularit, vetëm me një klikim të shpejtë.

Objektivi kryesor i kompanisë është investimi i mëtejshëm në teknologjinë digjitale për ta bërë shërbimin ndaj atyre që na besojnë jetën, shëndetin, pronën, automjetin dhe çdo gjë tjetër me vlerë më të shpejtë, më të thjeshtë dhe më efikase.



HISTORIKU

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA – Kosova u themelua në vitin 2003 në kuadër të ndërkombëtarizimit të aktivitetit të SIGAL sh.a përmes blerjes së një kompanie ekzistuese të sigurimeve.

SIGAL Kosova është licencuar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës si kompani e sigurimit të përgjithshëm të jo-jetës.

Ndërsa në vitin 2011 do të themelohej edhe SIGAL Life UNIQA Group AUSTRIA, e licencuar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës si kompani e sigurimit të jetës.

SIGAL UNIQA Group Austria – Kosova është e vetmja kompani që ofron të gjitha klasat e sigurimit, Jo-Jetë dhe Jetë.

Planet dhe sfidat për 2024-ën

SIGAL UNIQA Group Austria e mbyll vitin 2023 aty ku e nisi, si kompania më e madhe dhe më e besuar e sigurimeve në Shqipëri dhe jo vetëm.

Në një intervistë për Top News, CEO i “SIGAL UNIQA Group Austria”, z. Avni Ponari, bëri një rezyme të vitit që po lemë pas duke u shprehur me nota pozitive edhe sa i përket ndërgjegjësimit të qytetarëve mbi sigurimet vullnetare.

“2023 ka qenë një vit sfidash të mëdha. Ka qenë një vit i rritjes të të ardhurave dhe primeve por ka qenë edhe një vit i ndërgjegjësimit të qytetarëve për të patur më shumë sigurime.

SIGAL UNIQA është në pozitat kryesuese në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut. Ajo zë vendin e parë në këto tri shtete dhe natyrisht mban vendin e parë edhe në pagesën e dëmeve”, shprehet ndër të tjera z.Ponari.

Por si pritet të jetë viti 2024 për SIGAL UNIQA-n? Çfarë sfidash e presin?

“Në 2024-ën sfidat janë edhe më të mëdha. Veçanërisht përqëndrimi do të jetë në sigurimet online, në ofrimin e produkteve që janë më të kërkuara dhe më të sakta për të krijuar një pavarësi sa më të plotë për çdo qytetar. Sepse e kemi thënë që, nëse je i siguruar dhe je i mbuluar me të gjitha produktet atëherë ti nuk ke më nevojë të shkosh zyrave të shtetit apo administratës shtetërore duke shmangur të gjitha burokracitë dhe duke përfituar atë që të takon bazuar në kontratën e sigurimit. Prandaj, kjo mbetet sfida jonë gjithmonë.

Ndaj, bota europiane dhe bota e civilizuar mbulimet në sigurim i ka një faktor të rëndësishëm për të krijuar një qytetar të lirë dhe të pavarur nga administrata shtetërore”



Vetëm 1 në 35 mijë ka një pension privat **Ponari: Do të duhej të kishim 20-30% të të punësuarve kontribuues**



Vetëm një në 35 mijë të punësuar në vend derdh diçka nga rroga e vetë në skemat private të pensioneve.

Të dhënat tregojnë se nga mbi 1.3 milionë të punësuar, numri i kontribuuesve vullnetarë në fund të shtatorit ishte 38,001. Tënë ndryshe 2.9% e totalit.

“Do të duhej në fakt që ne të kishim 20-30% të të punësuarve kontribuues. Jemi në nivele shumë të ulëta. Duhet menduar si diçka e nevojshme, veçanërisht për ata që duan të jetojnë me dinjitet“, thotë për A2 CNN Elvis Ponari, CEO i “SIGAL Pension” dhe kryetar i Shoqatës së Siguruesve të Jetës dhe Pensioneve.

Të dhënat nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare tregojnë se nga dhjetori i shkuar e deri në shtator të këtij viti, numri i kontribuuesve u rrit me vetëm 1,483 individë të rinj.

Thënë ndryshe, skemës iu shtuan çdo muaj, rreth 210 vetë.

Vetëm një në 35 mijë të punësuar në vend derdh diçka nga rroga e vetë në skemat private të pensioneve.

Të dhënat tregojnë se nga mbi 1.3 milionë të punësuar, numri i kontribuuesve vullnetarë në fund të shtatorit ishte 38,001. Tënë ndryshe 2.9% e totalit.

“Do të duhej në fakt që ne të kishim 20-30% të të punësuarve kontribuues. Jemi në nivele shumë të ulëta. Duhet menduar si diçka e nevojshme, veçanërisht për ata që duan të jetojnë me dinjitet“, thotë për A2 CNN Elvis Ponari, CEO i “SIGAL Pension” dhe kryetar i Shoqatës së Siguruesve të Jetës dhe Pensioneve.

Të dhënat nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare tregojnë se nga dhjetori i shkuar e deri në shtator të këtij viti, numri i kontribuuesve u rrit me vetëm 1,483 individë të rinj.

Thënë ndryshe, skemës iu shtuan çdo muaj, rreth



UNIQA, anëtare e Eurapco Alliance

Pas një projekti pilot të suksesshëm njëvjeçar, UNIQA Insurance Group AG do të bëhet anëtare e përhershme e Eurapco Alliance në vitin 2024. Eurapco është një bashkësi strategjike në të cilën tetë kompani sigurimesh në Evropë bashkëpunojnë përmes shkëmbimit të njohurive, zhvillimit të orientuar nga biznesi dhe inovacionit të përbashkët. Fokusi është në transformimin dixhital, dixhitalizimin, inovacionin në shëndet dhe qëndrueshmëri.

Duke formësuar të ardhmen e industrisë Alliance është aktivisht e angazhuar në formësimin e të ardhmes së industrisë së sigurimeve. Në më shumë se 300 ngjarje dhe takime në vit, punonjësit e kompanive partnere ndajnë ekspertizën dhe praktikën më të mira në të gjitha fushat kyçe të biznesit. Synimi i partnereve të Eurapco është të forcojnë konkurrencën dhe aftësinë e tyre për inovim, dhe kështu aktivitetet e tyre në tregjet lokale. Ka gjithashtu një fokus i fortë në zhvillimin e zgjidhjeve të orientuara nga klienti.

Bashkëpunimi nëpër kufij, hierarki dhe funksione

"Jemi krenarë që jemi partnerë të përhershëm të Eurapco Alliance. Ky partneritet është në përputhje me strategjinë tonë UNIQA 3.0, e cila gjithashtu bazohet në bashkëpunim përtej kufinjve kombëtarë, hierarkive dhe funksioneve. Në një kohë që ndryshon shpejt dhe sfiduese, ne dëshirojmë të formojmë aktivisht të ardhmen e industrisë së sigurimeve nëpërmjet shkëmbimit reciprok," ka thënë Wolfgang Kindl, Anëtar i Këshillit Drejtues (Klientë & Tregjet Ndërkombëtare) i UNIQA Insurance Group AG.

"Me kënaqësi të madhe, mirëpresim UNIQA-n në Eurapco Alliance. Ky partneritet ofron një mundësi të shkëlqyeshme për Eurapco



për të përmirësuar shkëmbimin e njohurive, për të përshpejtuar biznesin dhe për të nxitur inovacionin, transformimin dixhital dhe iniciativat orientuar nga klienti brenda bashkësisë," shton Frauke Feess, Drejtor i Përgjithshëm i Eurapco.

Nxitja e shkëmbimit dhe transferimit të njohurive

Me më shumë se 50 grupe pune dhe një gamë të gjerë të aktiviteteve vjetore, rrjeti i Eurapco mbulon të gjitha aspektet e industrisë së sigurimeve. Si rezultat, Alliance shërben si një platformë për rrjetëzim ndërkombëtar dhe zhvillim të punonjësve. Kjo përfshin sidomos Akademinë Eurapco, e cila ofron format e ndryshme të mësimin me orientim ndërkombëtar dhe hulumtime thelluese.

UNIQA do të përdorë më shumë këto oferta për trajnimin e mëtejshëm të punonjësve të saj. Përveç kësaj, këto mundësi për arsimim dhe trajnim në nivel ndërkombëtar do të rrisin atraktivitetin e kompanive të sigurimeve pjesëmarrëse si punëdhënës.

Gjithashtu, Laboratori Eurapco, i dedikuar eksplorimit të zgjidhjeve të reja për të ardhmen e sigurimeve, mundëson projekte dhe mundësi biznesi të përbashkëta në mes të kompanive partnere.



Më shumë se një kompani sigurimi

Përgjegjësi sociale

Bashkohu me ekipin më të mirë

Aktivitet sportive mund të shoqërohen edhe me dëmtime por me Sigurimin e Aksidenteve nga SIGAL UNIQA je i sigurt.

Apliko
Online

sigal.com.al
+355 4 2233 308



Sponsorizimi i Kombëtares Ponari: Vjen në kuadër të përgjegjësisë sociale të kompanisë, detyrim moral ndaj 1.2 milionë klientëve në 3 shtete



Pjesëmarrja në një garë të rëndësishme si Kampionati Evropian i Futbollit, krijon potenciale përfitimesh të dyanshme edhe në marrëdhëniet me sponsorët e Kombëtares.

Avni Ponari, Drejtor i Përgjithshëm i SIGAL UNIQA Group Austria, në një intervistë për revistën "Monitor", shprehet se, të qenurit sponsor i Kombëtares është një reklamë e mirë për kompaninë. Megjithatë, sipas tij, kostot e sponsorizimit janë më të larta se kthimi që merr kompania.

Deri tani, sipas z.Ponari, SIGAL UNIQA, sponsorizimet në sport i ka ndërmarrë në kuadër të përgjegjësisë sociale, më shumë sesa të kthimit që një investim i tillë mund të sjellë.

Gjatë intervistës ai përsërit edhe një herë apelin për një ligj të veçantë për sponsorizimet në sport, i cili fatkeqësisht ende mungon në Shqipëri dhe do nxiste bizneset të investonin.

"Mungesa e një ligji për sponsorizimet, që vazhdoj ta them, krijon vështirësi", shprehet CEO i "SIGAL UNIQA Group Austria".

INTERVISTA

MONITOR: *SIGAL UNIQA është një nga sponsorët e Kombëtares shqiptare të futbollit. Si e vlerësoni impaktin e fushatës pozitive të elimatoreve dhe kualifikimin në European në rritjen e atraktivitetit të Kombëtares nga pikëpamja komerciale?*

AVNI PONARI: Që prej themelimit të saj, në shkurtin e vitit 1999, SIGAL UNIQA ka qenë gjithmonë një mbështetëse e fortë, jo vetëm e Kombëtares së Futbollit, por në shumë disiplina sportive: në basketboll, atletikë etj. Sot, ne jemi sponsor gjeneral të ekipeve të njohura në Shqipëri dhe Kosovë.

SIGAL UNIQA është sponsor gjeneral i klubit më të vjetër të futbollit në Shqipëri, Vllaznia e Shkodrës dhe e ekipit më të titulluar në basketbollin e Kosovës dhe jo vetëm, SIGAL Prishtina.

Sigurisht që, të mbështetësh djemtë e Kombëtares Kuqëzi është një tjetër ndjesi pasi ata janë krenaria jonë kombëtare dhe ambasadorët tanë më të mirë nëpër botë.

Që prej vitit 2016, SIGAL UNIQA Group Austria vijon të ketë nën mbrojtje, duke siguruar rreth 500 lojtarë të të gjithë Federatës Shqiptare të Futbollit si dhe stafin drejtues të Federatës.

Nëse flasim për kualifikimin për në fazën finale të Europeanit “Gjermani 2024”, përveç se gëzimit dhe emocioneve që na dhuroi, rrit përgjegjësinë tek kompania, pasi përveç kujdesit ndaj futbollistëve dhe stafit drejtues, duhet të mendojmë edhe për mijëra tifozë që do të shkojnë në Gjermani. Ndaj jemi duke përgatitur një sërë paketash Sigurimi që, udhëtimi dhe qëndrimi atje të jenë një eksperiencë e paharrueshme, por mbi të gjitha e sigurtë.

Sa i përket anës komerciale, sigurisht që të kesh emrin dhe logon në fanellat e Kombëtares dhe në stadium, është një reklamë e mirë për kompaninë.

MONITOR: Çfarë avantazhesh ofron për një biznes të qenit sponsor i Kombëtares së futbollit dhe a besoni se rezultatet e mira sportive përkthehen edhe në përfitime për imazhin/brandin e sponsorëve?

AVNI PONARI: Kombëtarja e Futbollit është vendi ky bashkohen të gjithë shqiptarët, brenda dhe jashtë Shqipërisë dhe ekspozimi i brandit në evente të tilla sigurisht që përkthehet në një marketing të mirë për SIGAL UNIQA-n.

Shpeshherë, gjatë ndeshjeve të Kombëtares në stadium, teksa shfaqej në fushë reklama e SIGAL UNIQA, kam dëgjuar shumë njerëz teksa thonë “SIGAL-i, ku kam siguruar makinën”, apo “Ja kompania e sigurimit ku kam sigurimin e shëndetit apo të shtëpisë”. Pra, mbetet një reklamë e mirë. Por më lejoni të ndalem në dy aspekte të rëndësishme:

E para, investimet e SIGAL UNIQA në sport por edhe në fusha të tjera, si arti, kultura etj, vijnë në kuadër të përgjegjësisë sociale. Si kompania më e madhe e sigurimeve në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut, e ndjejmë si detyrim moral karshi mbi 1.2 milion klientëve tanë që të jemi aktivë në jetën sociale të tre vendeve ku operojmë.

E dyta, mos harrojmë se, kostot e sponsorizimit janë gjithmonë më të larta se feedback-u që merr kompania.

Ndaj, unë vazhdimisht kam kërkuar një ligj të veçantë për Sponsorizimet në Sport, i cili fatkeqësisht ende mungon në Shqipëri dhe do nxiste bizneset të investonin në sport duke e bërë këtë të fundit më atraktiv dhe më të suksesshëm. Por deri tani insentivat kanë munguar, pavarësisht apelit të fortë që kemi bërë.

Mungesa e një ligji për sponsorizimet, që vazhdoj ta them, krijon vështirësi.

Edhe Kosova, një shtet i ri, e ka të përcaktuar me ligj sponsorizimin për aktivitetet sportive ku çdo biznes që sponsorizon sportin i njihet tatimi mbi fitimin në masën 30%.

Nuk e di nëse ka një vend të Europës që nuk ka ligj për sponsorizimet dhe një ligj të qartë... Ky ligj është gjithmonë i dyanshëm pasi ai formalizon sportin në të gjitha shtyllat e tij. Pikërisht këto ligje, në shtete të tjera, e kanë çuar sportin në nivele të larta.

Suksesi i Kombëtares na tregoi edhe njëherë se sporti gjeneron shumë të ardhura dhe prek thuajse të gjithë sektorët e ekonomisë. Ndaj, nuk duhet të kënaqemi me kaq por të mendojmë edhe ne si shtetet fqinje dhe europiane për zhvillimin e mëtejshëm të sportit.

Nuk duhet të harrojmë se sport elitari, pa mbështetje financiare, nuk ka dhe nuk mund të ketë! Dhe Kombëtarja e Futbollit është shembulli më i mirë për të ilustruar këtë fakt.

“Sporti prodhon para”. Katari, që organizoi Kampionatin Botëror 2022, përveç se arkëtoi miliarda dollarë gjatë ndeshjeve, po njeh edhe një bum turistik.

E njëjta ndodhi edhe me Greqinë fqinje në vit 2004, mikpritëse të Lojërave Olimpikë.

Si shumë ekspertë të ekonomisë, edhe unë jam i mendimit që Shqipëria duhet të besojë fort tek filozofia “sporti në funksion të ekonomisë”. Por siç e thamë më sipër, gjithçka duhet të nisë nga Ligji për Sponsorizimet në Sport.



UNIQA, kompania e parë austriake me synim në zvogëlimin e emetimeve



Sigurimet luajnë një rol kyç në zvogëlimin e mëtejshëm të ngrohjes globale dhe në arritjen e qëllimeve të Marrëveshjes së Parisit.

Sektori menaxhon rreth 11 trilionë euro vetëm në Evropë. Transformimi gjelbër i ekonomisë evropiane mund të ketë sukses vetëm nëse këto fonde investohen në kompani që operojnë në mënyrë të qëndrueshme.

"Jemi të vetëdijshëm për përgjegjësinë tonë dhe kemi vendosur synime ndërvepruese ambicioze: zero emetime deri në vitin 2040 në Austri dhe deri në vitin 2050 në të gjitha vendet e Grupit UNIQA. Kemi vendosur synime ndërvepruese për vitin 2030, dhe në përputhje me Synimet e Bazuar në Shkencë (SBTi), duke përdorur një kornizë të SBTi, dhe gjithashtu bashkëpunojmë me legjislatorët, klientët dhe kompanitë në të cilat investojmë. Portofoli i investimeve tona është në përputhje në mënyrë të qëndrueshme me synimin e Parisit për 1.5°C," shpjegoi René

Knapp. Përveç portofolit të investimeve, synimet ndërvepruese vëmendje të veçantë akordojnë në ekologjinë e biznesit të UNIQA, e cila përqendrohet në emetimet e gazit nga ngrohja globale ose makinat, por përfshin gjithashtu dhe energjinë elektrike ose ngrohjen e qytetit.

Validimi nga SBTi: Unik në Austri
Synimet e UNIQA për zvogëlimin e emetimeve nga investimet dhe në ekologjinë e biznesit deri në vitin 2030, tani janë shqyrtuar dhe konfirmuar nga SBTi, një thirrje për veprim nga organizatat kryesore për mbrojtjen e mjedisit dhe veprimin klimatik. SBTi është një partneritet midis CDP, Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Institutit të Burimeve Botërore (WRI) dhe Fondit Botëror për Natyrën (WWF). Iniciativa përcakton dhe promovon synime bazuar në gjetjet shkencore dhe verifikon këto synime të përcaktuara nga

kompanitë në mënyrë të pavarur.

UNIQA është e vetmja kompani sigurimesh në Austri, e cila ka arritur me sukses validimi për synimet ndërvepruese. Në gjithë sektorin financiar austriak, aktualisht nuk ka asnjë kompani tjetër për synimet ndërvepruese 1.5°C që janë njohur nga SBTi. Këto synime të përcaktuara nga shkenca bazohen në një parim të thjeshtë: ato fokusohen në sasi të emetimeve që duhet të zvogëlohen për të arritur qëllimin kryesor të Marrëveshjes së Parisit - për të kufizuar ngrahjen globale në 1.5°C.

"Ne po veprojmë në përputhje me zbulimet dhe principet shkencore për të zvogëluar emetimet tona të gazit. Jemi krenarë që synimet tona janë verifikuar dhe konfirmuar nga SBTi," tha Knapp. Sipas Knapp, kjo iniciativë nga një institucion i njohur gjithashtu forcon besueshmërinë e veprimeve të UNIQA dhe besimin e publikut.

"Sektori financiar ka një rol kyç në zvogëlimin e emetimeve në nivel global. Ne përshëndesim Grupin UNIQA për vendosjen e synimeve të përcaktuara nga shkenca, të cilat mbulojnë jo vetëm emetimet operative, por edhe portofolin e tyre të investimeve," tha Luiz Amaral, Drejtor i Përgjithshëm i SBTi.

"Synimet e Grupit UNIQA vijnë në një moment kyç për sektorin dhe tregojnë nevojën urgjente për veprim për të parandaluar efektet më të dëmshme të ndryshimeve klimatike."

Ju mund të gjeni të gjitha detajet në lidhje me synimet ndërvepruese të UNIQA të verifikuara nga SBTi [KËTU](#)

Qymyri, nafta dhe gazi natyror

UNIQA gjithashtu ka një rrugëtim të qartë për tërheqjen nga përdorimi i karbureve fosilë si qymyri, nafta dhe gazi natyror. Kompania tashmë nuk kryen më investime të reja në qymyr ose naftë, dhe nuk bashkëpunojmë me biznese në sigurimet e pronave të klientëve korporativë (nafta nga viti 2024).

Kërkesat brenda kornizës së planit të transformimit të UNIQA po bëhen gjithnjë e më të forta. Ndër të tjera, kjo nënkupton edhe fundin e përdorimit të naftës dhe qymyrit për investimet ekzistuese ose mbulimin e sigurimeve për klientët korporativë deri në vitin 2030. Mund të gjeni të gjitha detajet në "[Deklaratën e Dekarbonizimit](#)."

Energjia e gjelbër në UNIQA

Për të zvogëluar ndikimin ekologjik, UNIQA po ndërmerr hapa të përshtatshëm në fushën e ekologjisë së biznesit. Nisja e operimit të sistemit të ri fotovoltai në tarracën e selisë kryesore të UNIQA në verën e vitit 2023 - më i madhi ndonjëherë në një ndërtesë kompanie UNIQA - është një ndërhyrje e rëndësishme falë prodhimit të tij prej 125 kWp. Ai të jetë në gjendje të prodhojë 100,000 kWh energji elektrike në vit në të ardhmen. Kjo korrespondon me konsumin vjetor të rreth 30 shtëpive dhe do të shmangë emetime rreth 21 ton CO2 në total.

UNIQA ka rritur prodhimin e instaluar fotovoltai nga 50 kWp në mbi 400 kWp që nga viti 2020, një rritje tetëfish. Deri në vitin 2035, prodhimi fotovoltai duhet të jetë të paktën 600 kWp.

UNIQA ka blerë gjithashtu energji elektrike të gjelbër 100 për qind për vite në Austri. Nga viti 2024, vetëm energjia elektrike e gjelbër e caktuar nga Austrian Ecolabel 46 (UZ 46 "Green Electricity") do të blihet.

SCIENCE BASED TARGETS
DRIVING AMBITIOUS CORPORATE CLIMATE ACTION

Date of issue: November, 2023

UNIQA Insurance Group AG

Scope 1 and 2: UNIQA Insurance Group AG commits to reduce absolute scope 1 and 2 GHG emissions 42% by 2030 from a 2021 base year*.

*The target boundary includes biogenic land-related emissions and removals from bioenergy feedstocks.

Scope 3 Portfolio Targets

Headline target: UNIQA Insurance Group AG's portfolio targets cover 23% of its total investment and lending by assets under asset management as of 2021¹. As of that year, required activities made up 23% of UNIQA Insurance Group AG's total investment and lending by assets under asset management¹ while optional activities made up 19% and out of scope activities made up 58%².

Scope 3 asset class level targets

Asset class	Method	Target language
Electricity generation project finance	Sector Decarbonization Approach (SDA)	UNIQA commits to reduce its electricity generation project finance portfolio GHG emissions 74.2% per MWh by 2030 from a 2021 base year.

Mbrëmja Gala e Bamirësisë Orkestra "SIGAL UNIQA" ngroh shpirtrat e të pranishmëve me tingujt mahnitës të Vivaldit



Në Ditën Botërore të Vullnetarizmit dhe në 102-vjetorin e themelimit të Kryqit të Kuq Shqiptar u zhvillua mbrëmjen e sotme në Tiranë "Mbrëmja Gala e Bamirësisë".

Përveç interpretimit magjik të aktorese Roza Anagnosti dhe zërit të fuqishëm të Marsela Çibukaj, mbrëmjes nuk i mungoi as performanca e Orkestrës së Harqeve "SIGAL UNIQA", e cila ngrohu shpirtrat e të pranishmëve me tingujt mahnitës të kompozitorit të madh Vivaldi.

Mbrëmja u mbyll me ekspozitën e pikturave të realizuara nga vullnetarët, paratë e të cilave do të shkojnë për fëmijët që nuk shohin dhe nuk dëgjojnë.

SIGAL UNIQA, jetojmë më mirë së bashku Kompania më e madhe dhe më e besur e sigurimeve në vend dhe rajon, SIGAL UNIQA Group Austria, i ka dhënë një rëndësi të veçantë edhe përgjegjësisë sociale teksa ka qenë mbështetëse e shumë aktiviteteve, në fusha të ndryshme.

Pikërisht në kuadër të Përgjegjësisë Sociale ndaj Komunitetit dhe nën moton "jetojmë më



mirë së bashku", SIGAL UNIQA Group Austria, në vitin 2009 ngriti Klubin e Artit dhe Kulturës.

Në këtë klub janë zhvilluar dhjetëra aktivitete kulturore ndër të cilat ekspozita pikturë, mbrëmje muzikore, portrete artistësh, promovime librash dhe seminare me tematika të ndryshme.

Duke besuar se arti në përgjithësi dhe muzika në veçanti lumturon njerëzit duke shtuar shpresën tek ta, prej vitit 2013, pjesë e Klubit të Artit është Orkestra e Harqeve "SIGAL UNIQA", e përbërë nga 15 instrumentistë profesionistë dhe dirigjent Mjeshttrin e Madh Ermir Dizdari.

Mirë u takofshim në aktivitete të tjera

SIGAL Audiobooks.al iu ribashkua Panairit të 26-të të Librit



Në mjediset e Pallatit të Kongreseve në Tiranë, nga data 15-19 nëntor, do të mbahet Panairi i 26 I Librit, një ngjarje mbarëkombëtare e kulturës që pritet me shumë interes.

Panairi i përvitshëm i librit mbledh bashkë shtëpitë botuese nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi, shkrimtarë, poetë, përkthyes dhe lexues, ku njihen me botimet e reja, diskutojnë mbi problematikat e letërsisë bashkëkohore, përkthimit në gjuhën shqipe dhe shumë aktivitetet të tjera me të autorë dhe studiues.

Por këtë vit, panairit i ribashkohet edhe e vetmja “Librari Digjital” në Shqipëri, “SIGAL Audiobooks”. Platforma e parë dixhitale e librave audio në shqip, e cila sjell te shqiptarët brenda dhe jashtë kufijve pa asnjë kosto, librat e autorëve më të njohur vendas dhe të huaj, do të jetë për 5 ditë rresht me stendën e saj në panair ku çdo vizitor do të ketë mundësinë të njihet nga afër se çfarë është kjo platformë, çfarë ofron, si mund të përdoret dhe të testojnë live aplikacionin.

Për shkak edhe të zhvillimeve teknologjike dhe jo vetëm, Audiobooks-et janë një formë shumë efiçente për ta sjellë librin, informacionin, kulturën edhe tek ata që mbase nuk e kanë kohën të shfletojnë një libër fizik. Ndaj, mos harroni! Përgjatë pesë ditëve, nga 15 deri më 19 nëntor, “SIGAL Audiobooks” ju mirëpret ta vizitoni në “Panairin e Librit”, në Pallatin e Kongreseve.

“SIGAL Audiobooks, merreni Librarinë kudo me vete”

Aktualisht në “SIGAL Audiobooks.al” gjenden mbi 300 libra dhe informacione mbi sigurimet, të gjitha të disponueshme dhe të aksesueshme online për të gjithë. Ndërsa janë mbi 50 mijë përdorues, të cilët në çdo moment mund të dëgjojnë falas, nga celulari ose kompjuteri, titujt që dëshirojnë.

Në “Audiobooks.al” e gjejnë veten duke filluar që nga fëmijët e moshave të vogla, duke dëgjuar përrallat e tyre të preferuara, fëmijët pak më të rritur me librat shkollorë apo libra artistikë që u përshtaten moshës së tyre dhe deri tek të rriturit, që mund të dëgjojnë romane, histori, kulturë, e plot libra interesante dhe me vlera të mëdha.

Librat vijnë tek përdoruesit nëpërmjet zërave të njohur të personazheve që kanë shumë vite eksperiencë në gazetari dhe jetën publike, dhe me profesionalizmin dhe zërin e tyre unik përcjellin tek çdo dëgjues librat më të mirë të epokës moderne, si dhe të historisë e kulturës së vjetër mesjetare e të Rilindjes. Mjafton të shkarkoni aplikacionin në App Store ose Play Store për të dëgjuar kudo dhe kurdo librat që dëshironi.

Regjistrimi është shumë i thjeshtë. Shkoni te pjesa “Login” dhe me vetëm një adresë e-maili mund të jeni një prej mijëra përdoruesve.

Jo thjesht një kompani sigurimesh

‘UNIQA’ vijon traditën, dorëzon çekun për “Caritas Austria”



Që prej vitit 1989, “Caritas Hospice” u ka mundësuar njerëzve të sëmurë dhe atyre në nevojë një strehë ku mund të kalojnë ditët e tyre të fundit në mënyrë të ngrohtë dhe të sigurt.

Punonjësit e qendrës dhe vullnetarët e tyre janë një mbështetje e fuqishme jo vetëm për ta, por edhe për amiljarët e tyre. Por që nuk duhen anashkaluar donatorët dhe ndihma e vazhdueshme, edhe monetare, që ata japin.

“Raiffeisen Bank International AG” dhe “UNIQA” kanë mbështetur “Caritas Austria” që prej vitit 2004.

Këtë vit ishin Drejtori i Përgjithshëm i RBI, Johann Strobl dhe anëtari i bordit të UNIQA, René Knapp, që i dorëzuan Klaus Schwertner, Drejtorit të Caritas-it në Kryedioqezën e Vjenës, çekun e përbashkët prej 70,000 eurosh.

“Kujdesi për qendrën po bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm. Punonjësit e “Hospice Caritas” bëjnë një punë të pallogaritshme për t’ju dhënë

pacientëve me sëmundje terminale dhe familjeve të tyre mbështetje që u nevojitet. Jemi të kënaqur që, së bashku me RBI-në, kemi mundur të japim një kontribut në ruajtjen e këtij shërbimi thelbësor për gati dy dekada“, është shprehur René Knapp.

“KUSH ËSHTË “UNIQA INSURANCE GROUP”?

“UNIQA Insurance Group” daton prej vitit të largët 1811 kur u themelua “Salzburger Landes-Versicherung”.

Ndërsa sot, kompania mban emrin e saj në rangun e lartë të industrisë së sigurimeve, me një shtrirje në 17 shtete ku operon përmes 40 kompanive.

UNIQA ofron të gjitha kategoritë e sigurimit, ndërsa produktet e saj shkojnë tek klienti përmes marketingut ekskluziv, ndërmjetësve, agjencive të përgjithshme dhe shitjeve online.

Sipas studimeve të pavarura, “UNIQA Insurance Group” është prej shumë vitesh marka më e njohur dhe më e besueshme e sigurimeve në Austri.

Ajo numëron rreth 22,400 punonjës dhe mbi 16 milionë klientë

“UNIQA Insurance Group”, i pari investitor strategjik në tregun shqiptar të sigurimeve “UNIQA Insurance Group” ishte i pari investitor strategjik në tregun shqiptar të sigurimeve.

Që prej 23 mars 2007, kompania austriake zotëron rreth 87% të aksioneve të kompanisë së parë shqiptare të sigurimeve, SIGAL.

SIGAL UNIQA, pikërisht përmes “UNIQA Insurance Group”, solli për herë të parë në Shqipëri Sigurimin Privat të Shëndetit ndërsa sot, kompania më e madhe e sigurimeve në Shqipëri dhe rajon, me mbi 1,2 milion klientë, ofron shërbime inovatore për vendin dhe jo vetëm siç janë “TeleShëndet”, “Jetë Plus”, “Sigurimi anti Tumor”, “Check Up sipas Protokollit japonez” apo “SIGAL UNIQA AutoSOS”, paketa sigurimi dhe shërbime me benefite dhe me mbulime brenda e jashtë Shqipërisë, si asnjë kompani tjetër sigurimi.

Fatkeqësitë natyrore janë të papritura, por me SIGAL UNIQA ti je një hap përpara

Sigurim i Pronës
në SIGAL UNIQA

Blije
Online

sigal.com.al
+355 4 2233 308

